REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike

Dokument parlamentar

Tiranë, më 02.11.2026

RAPORT

(Komision Për Dhënie Mendimi)

PËR SHQYRTIMIN NË PARIM

TË PROJEKTLIGJIT

"PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.29/2023, "PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT" , TË NDRYSHUAR"

TË PAKETËS FISKALE

(QË SHOQËRON PROJEKTLIGJIN E BUXHETIT TË SHTETIT)

•Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike, në cilësinë e Komisionit Për Dhënie Mendimi, në mbledhjen e datës 02.11.2026, mori në shqyrtim në parim projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.29/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar".

Bazuar në vendimin e Konferencës së Kryetarëve, Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike shqyrtoi në parim pesë projektligjet e paketës fiskale që shoqërojnë projektligjin e buxhetit të shtetit, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32, 38 dhe 70 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin z. Ermal Pacaj.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm dhe përfaqësues nga Ministria e Financave, z. Petrit Malaj, Ministër, si edhe përfaqësues nga stafi teknik.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGIT

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

Shqyrtimi i këtij projektligji mbështetet gjithashtu në procedurën e posaçme të përcaktuar në Kreun III të pjesës së dytë të Rregullores së Kuvendit, përkatësisht në nenet 78–85, që rregullojnë shqyrtimin e projektligjit të buxhetit të shtetit dhe të projektligjeve financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të.

Sipas nenit 78, projektligji i buxhetit dhe projektligjet financiare të lidhura drejtpërdrejt me të përfshihen menjëherë në programin e punës së Kuvendit dhe shqyrtohen sipas një kalendari të veçantë parlamentar. Në mbështetje të nenit 79, Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat është komisioni përgjegjës për shqyrtimin e këtyre nismave, ndërsa Konferenca e Kryetarëve përcakton kalendarin e posaçëm të shqyrtimit, sipas procedurës së parashikuar në këtë dispozitë.

Në përputhje me nenin 80, komisionet e përhershme, sipas fushave të përgjegjësisë, shqyrtojnë projektligjet financiare dhe hartojnë raportet përkatëse të vlerësimit, të cilat i përcillen komisionit përgjegjës. Në këtë kuadër, Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike shqyrton projektligjet nga pikëpamja e kushtetutshmërisë, ligjshmërisë, sigurisë juridike dhe teknikës legjislative.

Neni 81 përcakton procedurën e shqyrtimit në parim në Komisionin për Ekonominë, Punësimin dhe Financat, i cili shqyrton edhe raportet e komisioneve të tjera.

Ndërsa, sipas nenit 82, në seancë plenare shqyrtohen dhe votohen në parim fillimisht projektligjet financiare që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me buxhetin dhe, më pas, projektligji i buxhetit të shtetit.

Nenet 83 dhe 84 rregullojnë fazat pasuese të shqyrtimit nen për nen dhe të votimit në tërësi, ndërsa neni 85 shtrin zbatimin e kësaj procedure edhe për ndryshimet që mund të bëhen gjatë vitit në ligjin e buxhetit dhe në ligjet financiare të lidhura drejtpërdrejt me të.

Nga pikëpamja juridike, shqyrtimi në parim i projektligjit përqendrohet në respektimin e parimeve kushtetuese të ligjshmërisë së detyrimeve fiskale, barazisë përpara ligjit, sigurisë juridike dhe proporcionalitetit, si dhe në përputhshmërinë e nismave me sistemin juridik në fuqi.

Projektligji shoqërohet me relacionin përkatës, në përputhje e kërkesat e nenit 68 pika 2 të Rregullores[1] së Kuvendit, *(është në formën e një akti normativ dhe shoqërohet me relacionin shpjegues ku përcaktohet qëllimi, objektivat dhe baza ligjore)*.

Ky projektligj përbëhet nga 8 nene.

Projektligji i propozuar është **në përputhje me legjislacionin e brendshëm, si edhe në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar.**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në "Fletoren zyrtare" dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2027.

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE PËRMBAJTJA E TIJ

[1] Rregullorja e Kuvendit

Ky projektligj ka për qëllim përmirësimin e mëtejshëm të politikave tatimore, në funksion të forcimit të drejtësisë dhe neutralitetit fiskal, rritjes së progresivitetit të sistemit tatimor dhe sigurimit të një shpërndarjeje më të balancuar të barrës tatimore ndërmjet kategorive të ndryshme të të ardhurave dhe tatimpaguesve.

Në këtë kuadër, ndryshimet e propozuara përfshijnë rishikimin e normës së tatimit mbi të ardhurat nga dividendët, saktësimin e përkufizimit të dividendit me qëllim parandalimin e shmangies së detyrimeve tatimore nëpërmjet shpërndarjeve të tërthorta të fitimit, përshtatjen e strukturës progresive të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, si dhe saktësimin dhe unifikimin e trajtimit tatimor favorizues për kategori të caktuara individësh.

Njëkohësisht, projektligji synon thjeshtimin e procedurave të përmbushjes së detyrimeve tatimore dhe reduktimin e barrës administrative për tatimpaguesit, nëpërmjet eliminimit të detyrimit për dorëzimin e dyfishtë të pasqyrave financiare pranë administratës tatimore dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit.

II. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Ky projektligj nuk synon përafrimin me ndonjë acquis të Bashkimit Evropian.

III. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

IV. RAPORTI I VLERËSIMIT TË SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj parashikohet të sjellë efekte financiare në buxhetin e shtetit, si më poshtë vijon:

- Për përjashtimin nga tatimi mbi të ardhurat personale nga punësimi për kategoritë e personave me aftësi të kufizuar, efekti nuk është i ndjeshëm për arsye se në bazë të të dhënave të administratës tatimore ka një numër të vogël aktual të të punësuarve;

- Për përjashtimin nga tatimi mbi të ardhurat e biznesit, për të vetëpunësuarit e vetëm, efekti do të jetë në mars 2028, kur të dorëzohet deklarata e të ardhurave personale nga biznesi për vitin tatimor 2027. Kategoria "i vetëpunësuar i vetëm" është e përcaktuar në udhëzimin përkatës për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe njihet si kategori e veçantë në sistemin e deklarimit të listëpagesës. Vlerësimi më i saktë do të jetë kur të hartohet buxheti i vitit 2028, për të vlerësuar numrin e kësaj kategorie gjatë vitit 2027;

- Rritja e normës së tatimit mbi dividendin nga 8% në 15%, duke marrë në konsideratë edhe ndikimin e rritjes së normës tatimore në vendimmarrjen e shoqërive për shpërndarjen e fitimeve, gjeneron një efekt pozitiv vjetor në buxhetin e shtetit prej +3,04 miliardë lekësh në vit.

- Rishikimi i formulës së tatimit mbi të ardhurat personale (TAP) nga punësimi: Rritja e pragut të fashës 13% nga 200 000 në 300 000 lekë/muaj përkthehet në një lehtësim tatimor të drejtpërdrejtë për 25 704 punonjës në vlerën rreth -1,98 miliardë lekë në vit, kosto, e cila zbutet më tej nga të ardhurat shtesë prej 0,76 miliardë lekësh në vit, që gjeneron aplikimi i normës

margjinale prej 3% për pagat bruto mbi 700 000 lekë/muaj, pra, me një efekt neto prej -1.22 miliardë lekësh në vit.

Në total, ndryshimet e propozuara parashikohen të gjenerojnë një efekt neto pozitiv në të ardhurat e buxhetit të shtetit prej rreth 1.82 miliardë lekësh në vit, bazuar në efektet financiare të vlerësuara për politikat e mësipërme, ndërkohë që efektet e lehtësive tatimore për kategoritë e personave me aftësi të kufizuara dhe të ndryshimeve në skemën e sponsorizimeve do të vlerësohen më saktë gjatë hartimit të buxhetit të vitit 2028.

V. OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Bazuar në nenin 68, pika 2 e Rregullores, projektligji në relacionin nuk paraqet përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Agjenda e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

VI. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komision nga relatori u vlerësua ndërmarrja e kësaj nisme ligjore. Komisioni mbështeti qëndrimin e relatorit dhe e vlerësoi projektligjin shumë të rëndësishëm për përmirësimin e mëtejshëm të politikave tatimore, në funksion të forcimit të drejtësisë dhe neutralitetit fiskal, rritjes së progresivitetit të sistemit tatimor dhe sigurimit të një shpërndarjeje më të balancuar të barrës tatimore ndërmjet kategorive të ndryshme të të ardhurave dhe tatimpaguesve.

VII. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit në parim të këtij projektligji, i cili është pjesë e paketës fiskale që shoqëron projektligjin për buxhetin e shtetit, Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike, në cilësinë e Komisionit Për Dhënie Mendimi, votoi projektligjin dhe me shumicën e votave, e miratoi atë në parim. Më pas raporti t'i përcillet Komisionit Përgjegjës sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

RELATOR **KRYETAR**

ERMAL PACAJ **ULSI MANJA**